

**4 dhjetor 2025,
Prishtinë**

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 04.12.2025, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR.13/ 2025-26 I KOMISIONIT TË GARAVE

- I.** Komisioni i Garave ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga KB New Basket Prizreni për regjistrimin e lojtarit Ujkan Karanezi si lojtar i lirë ("free agent")¹ jashtë afatit kalimtar.
- II.** Pas shqyrtimit të kësaj kërkeje dhe në bazë të Rregullores për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së për sezonin 2025/2026, Komisioni i Garave MIRATON kërkesën e KB New Basket Prizreni për lejimin e regjistrimit të lojtarit Ujkan Karanezi.
- III.** Ky vendim hyn në fuqi nga data e publikimit.

¹ **Lojtar i lirë (free agent)** – lojtar të cilit i ka përfunduar kontrata me ekipin e tij të mëparshëm (nuk ka kontratë aktive/valide) dhe është i lirë të nënshkruajë një kontratë të re me cilindo ekip tjetër. Një lojtar i lirë ka të drejtë të negociojë dhe të pranojë oferta nga ekipet e tjera pa kufizime të vendosura nga ekipi i tij i mëparshëm.

ARSYETIM


Gjatë vendimarrjes lidhur me dispozitivin e Vendimit Nr.13/2025-26, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

- (a) Klubi KB New Basket Prizreni ka paraqit kërkesë për regjistrimin e lojtarit Ujkan Karanezi si lojtar **të lirë (free agent) jashtë afatit kalimtar.**
- (b) Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se lojtari nuk ka kontratë aktive me asnjë klub, duke plotësuar kështu kushtet për statusin e lojtarit të lirë.
- (c) Duke qenë se plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregulloren për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së për sezonin 2025/2026 neni 13 par. 6, Komisioni i Garave miraton regjistrimin e lojtarit Ujkan Karanezi për klubin KB New Basket Prizreni.

Komisioni i Garave:


Arianit Shala

Anëtar



Armend Hamiti

Kryetar



Ismet Ferati

Anëtar

Federata e Basketbollit të Kosovës

KËSHILLË JURIDIKE: Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2025/2026, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.